



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2020:183132

Datë: 22.08.2023

Numri i dokumentit: 04604213

Pml.nr.214/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar, Valdete Daka dhe Agim Maliqi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit S.B. nga G.M., Republika e S., për shkak të veprës penale krime lufte kundër popullatës civile nga neni 142 të LP të RSFJ-së, si ligj në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, aktualisht e ndëshkueshme sipas veprës penale krime lufte në shkëlqje të rëndë të nenit 3 par.1 shkronja a/b dhe c të përbashkët për Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949 dhe nenit 4.2 shkronja c) dhe e të Protokollit II, aktualisht i ndëshkueshëm edhe nga neni 146 të KPRK, duke vendosur lidhur me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të dënuarit S.B. dhe mbrojtësit të tij e ushtruar kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PS.nr.49/2021 datë 08.09.2022, dhe aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special APS.nr.49/2022 datë 19.01.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 14 gusht 2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të dënuarit S.B. dhe mbrojtësit të tij ushtruar kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PS.nr.49/2021 datë 08.09.2022, dhe aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special APS.nr.49/2022 datë 19.01.2023.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special PS.nr.49/2021 datë 08.09.2022, i dënuari S.B. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale krime lufte kundër popullatës civile nga neni 142 të LP të RSFJ-së, si ligj në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, aktualisht e ndëshkueshme sipas veprës penale krime lufte në shkelje të rëndë të nenit 3 par.1 shkronja a/b dhe c) të përbashkët për Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949 dhe nenit 4.2 shkronja c) dhe e të Protokolit II, aktualisht i ndëshkueshëm edhe nga neni 146 të KPRK, dhe i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjet, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e qëndrimit në paraburgim nga data 22.12.2020 e tutje. I dënuari është obliguar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 100 € si dhe në emër të Fondit për Kompensim të Viktimave të Krimit shumë prej 50 € e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktgjykimin APS.nr.49/2022 e datës 19.01.2023, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e palëve ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë paraqitur:

- i dënuari S.B. për shkak të gjykit të kundërligjshëm dhe të montuar në Gjykatën Themelore dhe atë të Apelit në Prishtinë, me propozim që aktgjykimet të ndryshohen dhe i njëjti të lirohet nga akuza si dhe

- mbrojtësi i të dënuarit avokati Dejan Vasiq nga Mitrovica, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe shkeljes së dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit me propozim që aktgjykimet të ndryshohen dhe i dënuari të lirohet nga akuza ose të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Prokurori i Shtetit, me shkresat KML.II.nr.133/2023 datë 23.05.2023 dhe datë 02.08.2023, ka propozuar që të refuzohen si të pabazuara kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitura nga vetë i dënuari dhe mbrojtësi i tij.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e kësaj çështjeje penale në kuptim të nenit 435 par.1 dhe nenit 436 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet nga kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesat nuk janë të bazuara.

Në kërkesë të paraqitur nga vetë i dënuari S.B., i cili nuk ka paraqitur bazat ligjore mbi të cilin mund të ushtrohet ky mjet juridik, por duke iu referuar gjendjes faktike e sidomos deklaratës së të dëmtuarës T.K. pretendon se që të dy gjykatat kanë marrë një vendim i cili është hakmarrje ndaj të njëjtit dhe se si i tillë është një vendim i paligjshëm dhe skandaloz.

Në kërkesën e tij mbrojtësi i të dënuarit avokati Dejan Vasiq pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.1 e lidhur me nenin 38 par.2 të KPP, kjo për faktin se në Gjykatën e Apelit me rastin e vendimmarrjes kryetari i kolegjit, gjyqtari Burim Ademi ka marrë vendim lidhur me ankesën e datës 07.02.2022 e gjithashtu ishte anëtar i kolegjit që ka marrë aktvendimin e datës 23.08.2021, ndërsa gjyqtari raportues Vaton Dërguti, ka kryesuar kolegjit që refuzuan ankesat dhe mori aktvendime të datave 08.12.2021, 09.02.2020, 31.12.2020, 23.08.2021 si dhe ishte anëtar i kolegjit gjatë marrjes së aktvendimeve të datës 19.04.2022, 1.10.2021 dhe 20.05.2021 sikurse edhe anëtar i kolegjit gjyqtari Ferit Osmani i cili ishte anëtar i tre kolegeve që kanë vepruar në procedurën e mëparshme dhe atë më datën 23.09.2022, 19.04.2022 dhe 07.02.2022 kur kolegji kryesohej nga gjyqtari Burim Ademi. Për këtë çështje këta gjyqtarë është dashur ta informojnë kryetarin e Gjykatës së Apelit dhe të kërkojnë përjashtimin e tyre. Edhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është përkthyer keq dhe ka disa pjesë të arsytimit që nuk kuptohen e për më tepër Gjykata e Apelit nuk ka dhënë arsye lidhur me pretendimet ankimore.

Më tutje ,mbrojtësi i referohet deklaratës së të dëmtuarës T.K. e cila ka dhënë dy deklarata, njëren gjatë procedurës hetimore dhe deklaratën tjetër para kolegjit për mundësi të hetimit të veçantë në të cilën seancë ishte i pranishëm edhe i dënuari duke deklaruar se ky person nuk ishte personi i cili e kishte rrëmbyer ditën kritike edhe dëshmitari M.S. në deklaratën e tij ishte kontradiktor me deklaratat e tij të mëparshme edhe po ashtu me deklaratën e të dëmtuarës T.K., andaj si është e mundur që gjykata i beson të dëmtuarës apo deklaratës së rreme të dëshmitarit M.S. e për çka asnjëra prej gjykatave nuk ka dhënë përgjigje në këtë pyetje. Ndërsa prokurori i çështjes me aktakuzën e tij ka dal jashtë kornizës së provave të paraqitura të cilat janë të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit kur pretendon se “...në prezencën e shumë personave të tjerë e mbështet për muri kurse **vetë me armë** në dorë i rri përballë në distancë shumë të afërt e në ndërkohë vije fqinji i të dëmtuarës, dëshmitari M.S. **i cili përleshet me të pandehurin duke e goditur me grusht...**”, e çka nuk është vërtetuar fare por janë shpikur nga prokurori i çështjes, meqenëse asnjë nga dëshmitarët nuk ka deklaruar atë për çka i dënuari është ngarkuar me aktakuzë.

Kjo gjykatë duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa si dhe duke u bazuar në shkresat e kësaj çështje gjen se aktgjykimet nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara nga ana e mbrojtjes dhe të dënuarit. Kështu sa i përket kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga ana e të dënuarit (person laik) kjo gjykatë gjen se i dënuari në fakt pretendon se nuk ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor andaj edhe gjykata për kundër faktit që në kërkesë nuk paraqiten arsyet konkrete për të cilat është paraqitur, e shqyrtoi në këtë drejtim.

Sa i përket pretendimeve se gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, anëtarët e kolegjit të cilët kanë vendosur lidhur me ankesën e mbrojtësit të dënuarit është dashur që të përjashtohen e konform dispozitës së nenit 38 par.2 të KPP-së, sepse në shumë raste kanë marrë pjesë në procedurë penale ashtu siç është potencuar në kërkesë, kjo Gjykatë gjen se gjyqtarët si kryetari i kolegjit Burim Ademi ashtu edhe gjyqtarët Vaton Dërguti dhe Ferit Osmani si anëtarë të kolegjit kanë marrë

pjesë në këtë çështje penale në procedurat e më parme por kjo ka ndodh me rastin e vendosjes lidhur me ankesat kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë lidhur me caktimin apo vazhdimin e paraburgimit ndaj të dënuarit ndërsa konform nenit 38 par.2 të KPP-së, ... “gjyqtari nuk përjashtohet kur ai ose ajo ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale si anëtar i kolegjit shqyrtues”. Për më tepër këta gjyqtarë nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në vendosjen meritorë në këtë çështje penale lidhur me fajësinë e të dënuarit, por vetëm lidhur me arsyeshmërinë e caktimit apo vazhdimin të paraburgimit si masë e sigurisë së prezencës së të dënuarit në procedurën penale.

Sa i përket pretendimit se gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsyetim lidhur me të gjitha pretendimet ankimore, kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore, për më tepër ka vlerësuar aktgjykimet e shkallës së parë edhe sipas detyrës zyrtare lidhur me shkeljet eventuale, e për të cilat kujdeset edhe kur nuk është paraqitur ankesë në atë drejtim. Për të gjitha pretendimet me arsyetim të aktgjykimit të shkallës së dytë janë dhënë vlerësime dhe arsyetim ligjor e me të cilin arsyetim dhe konstatime pajtohet edhe kjo gjykatë. Kështu, edhe pse mbrojtësi i të dënuarit në tërësi e konteston deklaratën e të dëmtuarës-dëshmitares T.K. e cila ka dhënë dy deklaratat dhe atë më datën 18.06.2021 dhe në seancën për mundësinë e hetuesisë së veçantë, më datën 16.07.2021, kjo gjykatë gjen se në deklaratën e parë e dëmtuara (e cila është analfabete) në cilësi të dëshmitares ka përshkruar ngjarjen e natës kritike dhe ka përshkruar edhe personin i cili e ka marrë dhe nën kërcënimin e pushkës e ka dërguar tek lokali, i cila gjendej në mes të fshatit B., ku edhe është zhvilluar e tërë ngjarja. Dëshmitarja e përshkruan personin i cili e ka marrë nga shtëpia e saj si “ai i B. dhe i thojshin hajn dhe se nuk ka qenë në uniformë”. Po ashtu, dëshmitarja që nga fillimin ka thënë se nuk është në gjendje ta identifikoj tani personin në fjalë, e për shkak se kjo ka ndodhur 20 e më shumë vite me parë. Megjithatë, në seancën e mundësisë hetuese të veçantë të mbajtur me datën 16.07.2021, dëshmitarja mbetet në tërësi pranë deklaratës së dhënë me 18.06.2021, duke mos e ndërruar dhe duke përsëritur se nuk është në gjendje ta identifikoj personin e asaj nate, por duke e precizuar se të personi që e ka marrë ka qenë komshi me ta, ashtu si ‘ç ka thënë që nga fillimi i procedurës dhe se e ka pas mbiemrin B. Pra e dëmtuara-dëshmitarja asnjë moment nuk ka pretenduar se e ka identifikuar të dënuarin, por e ka dhënë përshkrimin e tij sipas kujtesës së natës kritike si dhe ka përshkruar ngjarjen dhe faktin se as atëherë nuk e ka njohur, por bashkëshorti i saj, Rexhepi, atë natë i ka thënë se “e kemi kojshi, mos u tut”, ndërsa e ka cek se ky person ka pas armë. Andaj, edhe nuk mund të pranohet pretendimi se e dëmtuara e ka ndryshuar deklaratën dhe se deklaratat e saj janë kundërthënëse, ngase e njëjta asnjëherë nuk ka pretenduar se e njeh të dënuarin dhe se mund ta identifikoj.

Ndërsa, sa i përket deklaratës së dëshmitarit, M.S. dhe pretendimit e mbrojtjes se kjo deklaratë është në kundërshtim me deklaratën e të dëmtuarës T.K. dhe me veprimet e të dënuarit të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit, kjo gjykatë vlerëson se dëshmitari M.S., përndryshe edhe ai banor i fshatit B., ku ka ndodhur e tërë ngjarja, i cili e përshkruan ngjarjen nga momenti kur ka shkuar ta kërkon të dëmtuarën, e cila ishte marrë pa dëshirën e saj dhe nën kërcënimin e armës, duke deklaruar se e dëmtuara ishte e mbështetur për muri, duke qëndruar në këmbë e frikësuar, ndërsa S. ishte në distancë prej gjysmë metri nga ajo dhe bisedonte diçka me te. Më tutje, dëshmitari e përshkruan se si kishte grushtuar të dënuarin dhe e kishte e marrë të dëmtuarën,

të cilën e kishte kthyer në shtëpinë e saj e cila kishte mbetur aty deri në fund të luftës. Nga kjo deklaratë, e cila nuk bie në kundërshtim me deklaratën e të dëmtuarës, drejt ka konstatuar, gjykata e shkallës së parë se i dënuari e kishte marrë peng të dëmtuarën pa dëshirën e saj, nën kërcënimin e armës dhe e kishte dërguar në mes të fshatit, duke krijuar ankth dhe frikë të madhe tek e njëjta. Se i dënuari kishte armë, nuk është kontestuese ngase këtë e kishte përshkruar edhe e dëmtuara ,edhe dëshmitarët tjerë, të cilët edhe pse nuk ishin dëshmitar okular, megjithatë këtë ngjarje e kishin dëgjuar menjëherë pas luftës nga babai i tyre, tani i ndjeri R.K. Pra, fëmijët e të dëmtuarës, Z.B. (K.), H.K. si dhe nipi L.B., të gjithë këtë ngjarje e kishin dëgjuar nga vet e dëmtuara dhe bashkëshorti i saj dhe gjatë gjithë procedurës kanë mbet pranë deklaratave të tyre, duke i përshkruar edhe të dënuarin dhe ngjarjen.

Nga të gjitha këto, së bashku me provat të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor, drejtë ka ardhur në përfundim gjykata shkallës së parë kur ka gjet se në veprimet e të dënuarit formohen elementet e veprës penale, për të cilën edhe shpallur fajtor, aktgjykim ky i cili është vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë. Pra, drejt është aplikuar ligji material, sepse i dënuari veprimet inkriminuese i kishte ndërmarrë në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë, korrik-gusht të vitit 1998 dhe këto veprime ishin të drejtuara kundër popullatës civile, të cilët nuk ishin pjesëmarrës në luftime të cilat ishin duke u zhvilluar në atë kohë, përderisa këto viktima civile e gëzojnë mbrojtjen nga neni 3 i përbashkët për katër Konventës e Gjenevës ët vitit 1949, e të cilat veprime përmbushin elementet qenësore të veprës penale krime lufte kundër popullatës civile nga neni 142 të LP të RSFJ-së, si ligj në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, aktualisht e ndëshkueshme sipas veprës penale krime lufte në shkelje të rëndë të nenit 3 par.1 shkronja a/b dhe c) të përbashkët për Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949 dhe nenit 4.2 shkronja c) dhe e të Protokollit II, aktualisht i ndëshkueshëm edhe nga neni 146 të KPK.

Andaj, duke u nisur nga fakti se ndaj të dënuarit nuk është shkelur ligji penal në dëm të tij dhe se aktgjykimet nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të nenit 437 të KPP-së.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Pml.nr.214/2023, më 14 gusht 2023

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Rasim Rasimi

Numri i lëndës: 2020:183132
Datë: 22.08.2023
Numri i dokumentit: 04604213